Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno më/Dana: 06-05-2014
Nr.i organit / Org.broj: 01-013/602

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, nenit 36 pika d) të Statutit të Komunës se Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 29.04.2013, aprovon këtë:

# V E N D I M
## PËR SHPALLJEN ZONË ME INTERES TË PËRGJITHSHËM TË NGASTRËS KADASTRALE ME NR 823-0 NË ZONËN KADASTRALE NË RAMJAN

### Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, SHPALLË zonë me interes të përgjithshëm ngastrën kadastrale me nr. 823-0 me sipërfaqe prej 2249 $m^2$, në vendin e quajtur "nuka" Zonën Kadastrale në Ramjan e cila është në pronësi të Ferat (Nazif) Hysenit nga Ramjani i Komunës së Vitisë.

### Neni 2

Ngastrat kadastrale të shpallura zonë me interes të përgjithshëm nga neni 1 i këtij Vendimi, në Zonën Kadastrale në Ramjan do të shpronësohet me qëllim të interesit publik, përkatësisht për ndërtimin e gropës septike në fshatin Ramjan.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë e Komunës së Vitisë.

### Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:
1. Shërbimit të Kuvendit,
2. Drejtorisë për Kadastër
3. Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
4. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT
Naim Pira

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E VITISË - KUVENDI - REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA VITINA